

Titulli i lëndës: Kimia e përgjithshme

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë		
Titulli i lëndës:	Kimia e përgjithshme		
Niveli:	Bsc		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve/Semestri:	I (semestri i I-rë)		
Numri i orëve në javë:	2 + 2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	E enjte		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Ismet Hashani		
Detajet kontaktuese:	Tel: 044964670		
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë merret me konceptet e vetive fizike dhe kimike të materies, strukturën elektronike të atomit dhe parimet e përgjithshme të konfiguracionit elektronik, reaksionet kimike, ligjet e gazeve, vetitë e tretësirave, elementet dhe komponimet. Termodinamika dhe kinetika kimike. Reaksionet e oksido-reduktimit dhe elektrokimia.		
Qëllimet e lëndës:	Ky modul ka për qëllim aftësimin e studentëve për njohuritë themelore të kimisë: ligjet themelore dhe llogaritjet kimike. Njohuri themelore për strukturën e atomit dhe molekulës, vetitë e tretësirave dhe klasifikimin e elektrolitëve. Njohuri nga kinetika dhe termodinamika kimike, reaksionet e oksido-reduktimit dhe zbatimin e tyre në elektrokimi etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dalloj substancat e pastra nga përzierjet dhe metodat e ndarjes së tyre; • dijë pjesët përbërëse të atomit dhe ndryshimet periodike të vetive të elementeve kimike; • dijë të klasifikoj lidhjet kimike; • dijë të përgadis tretësira me përqendrime të ndryshme, të llogaritë dhe të matë pH-në e elektrolitëve të ndryshëm; • dalloj reaksionet endotermike nga ato ekzotermike dhe të përcjellë shpejtësinë e reaksioneve kimike; <p>barazoj reaksionet e oksido-reduktimit dhe zbatimin e tyre në elektrokimi</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e tënxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Konsultime	1	15	15
Ushtrime në teren	0	0	0
Seminare	2	2	4
Detyra shtëpie	1	15	15
Koha individuale e shpenzuar për studime (në bibliotek apo në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja finale për provim	1	5	5
Koha e shpenzuar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projekte, prezantime, etj.	2	2	4

Totali		150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënjes është e bazuar në: Ligjerata, ushtrime, seminare dhe debate, konsultime, detyra të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.	
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25%: Vlerësimi i dytë: 25%: Detyra shtëpie dhe seminare 10% Ardhja e rregullt: 5% Provimi final: 35% Totali : 100%	
Literatura		
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Azem Lajci , Vuksan Kalaj: KIMIA , për studentët e Mjekësisë, stomatologjisë dhe Biologjisë; Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1998. - M. S. Silberberg: Chemistry, 2. ed., McGraw- Hill, NewYork, 2000. 	
Literatura sheshtë:	<ul style="list-style-type: none"> - Bedri A. Kamberi; Bazat teorike së kimisë së përgjithshme dhe inorganike. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1997. - R. Chang: Chemistry, 6. ed., McGraw-Hill, NewYork, 2000. 	
Plani i dizajnuar i mësimi - Ligjerata		
Java	Ligjerata që do të zhvillohet	
Java e parë:	Struktura e materies dhe ndërtimi i atomit	
Java e dytë:	Elementet dhe komponimet kimike	
Java e tretë:	Masa dhe energjia, relacioni i tyre ne reaksionet kimike	
Java e katërt:	Ligji periodik dhe struktura elektronike e atomit	
Java e pestë:	Bazat e llogaritjeve kimike-Stekiometria.	
Java e gjashtë:	Lidhjet kimike dhe struktura kristalore	
Java e shtatë:	Gazet reale dhe ideale	
Java e tetë:	Uji dhe tretësirat ujore	
Java e nëntë:	Teoria e tretësirave, difuzioni, osmoza, dializa, baraspesha membranore	
Java e dhjetë:	Termokimia-Entalpia, Entropia dhe energjia e lirë e reaksionit kimik.	
Java e njëmbëdhjetë:	Kinetika dhe ekuilibri kimik	
Java e dymbëdhjetë:	Tretësirat dhe vetitë e tyre, përqendrimi i tretësirave.	
Java e trembëdhjetë:	Baraspeshat në tretësirat e elektrolitëve. Acidet dhe bazat, neutralizimi, tretësirat puferike, hidroliza e kripërave.	
Java e katërmëdhjetë:	Reaksionet e oksido-reduktimit dhe Elektrokimia	
Java pesëmbëdhjetë:	Njohuri të përgjithshme për grupeve kryesore të elementeve kimike	
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet	
Java e parë:	Laboratori, mjetet themelore dhe përdorimi i tyre, rregullat e sjelljes dhe masat mbrojtëse në laboratorin e kimisë.	
Java e dytë:	Veprimet kryesore të punës në laborator	
Java e tretë:	Metodat e ndarjes në laboratorin e kimisë: Filtrimi, Dekantimi, Centrifugimi, Distilimi, Ekstraktimi, Sublimimi, dhe Kristalizimi	

Java e katërt:	Sistemi ndërkombëtar i njësive matëse-SI
Java e pestë:	Ligjet themelore të kimisë
Java e gjashtë:	Simbolet dhe formulat kimike, Valenca, Përbërja në përqindje e komponimeve, ekuivalenti kimik.
Java e shtatë:	Masat atomike dhe molekulare relative
Java e tetë:	Reaksionet e Oksidimit dhe Reduktimit
Java e nëntë:	Gjendja e gaztë e materies, vetitë dhe ligjet e gazeve.
Java e dhjetë:	Klasifikimi i komponimeve inorganike
Java e njëmbëdhjetë:	Tretësirat
Java e dymbëdhjetë:	Elektrolitët : Shpërbashkimi elektrolitik, produkti jonik i ujit, vlera pH dhe Indikatorët.
Java e trembëdhjetë:	Tretësirat pufërike, hidroliza e kriprave dhe produkti i tretshmërisë.
Java e katërbëdhjetë:	Termokimia dhe kinetika kimike.
Java e pesëmbëdhjetë:	Elektroliza e disa kriprave dhe ligjet e Faradeut.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.